

1.0 Deklarata e Politikës, qëllimi dhe fushëveprimi

Universiteti i Miçiganit Sparrow/University of Michigan Sparrow është i përkushtuar t'u shërbejë banorëve të Shtetit të Miçiganit/Michigan të cilët nuk mund të përfitojnë kujdesin e nevojshëm mjekësor për shkak të aftësisë për të paguar.

Politika e Ndhmës Financiare e UMH Sparrow është krijuar për të identifikuar pacientët që mund të kualifikohen për ndihmë financiare.

Ndihma financiare u ofrohet pacientëve të cilët nuk janë në gjendje të paguajnë për kujdesin shëndetësor, sipas Udhëzimeve Federale të Varfërisë të SHBA-së (Federal Poverty Guidelines, FPG). Ndihma financiare konsiderohet si mjeti i fundit. Fillimisht, duhet të shqyrtohen të gjitha opsionet për përfitimin e siguracionit të palës së tretë ose për identifikimin e burimeve të disponueshme për pacientin.

Ndihma Financiare në UMH Sparrow administrohet nga Programi i Ndhmës Financiare i UMH Sparrow (Sparrow Financial Assistance Program, SFAP). Të gjitha kërkesat për ndihmë financiare duhet të shoqërohen me dokumentacionin përkatës. Pacientët që kualifikohen marrin një zbritje 100% në tarifat e pranueshme.

Kjo politikë zbatohet për UMH Sparrow Lansing, UMH Sparrow Carson, UMH Sparrow Clinton, UMH Sparrow Eaton, UMH Sparrow Ionia, Spitalin e Specialiteteve të UMH Sparrow/ UMH Sparrow Specialty Hospital, Grupin Mjekësor të UMH Sparrow/ UMH Sparrow Medical Group dhe Kujdesin në Shtëpi dhe në Azil të UMH Sparrow/ UMH Sparrow Home Care and Hospice.

Kjo politikë nuk zbatohet për qendrat e përcaktuara shëndetësore rurale NHSC të UMH Sparrow.

Kjo politikë nuk zbatohet për shërbimet e ofruara nga ofrues të papunë, megjithëse shumë ofrues të komunitetit njohin kriteret e UMH Sparrow dhe mund të zbatojnë zbritje të ngjashme.

Kjo politikë zbatohet për shërbimet e urgjencës ose shërbime të nevojshme nga ana mjekësore të ofruara nga UMH Sparrow dhe mjekët e punësuar prej tij, p.sh. ofruesit e mbuluar nga programi.

Kjo politikë nuk zbatohet për kujdesin e urgjencës ose kujdesin e nevojshëm nga ana mjekësore të ofruar nga ofrues ose grupe që nuk janë të punësuar nga UMH Sparrow, por që ofrojnë kujdes në ambientet e UMH Sparrow, p.sh. ofruesit e pambuluar nga programi. Ndërsa shumë ofrues ose grupe të pambuluara mund të njohin kriteret e UMH Sparrow dhe të zbatojnë zbritje të ngjashme, politikat e tyre për ndihmën financiare janë të pavarura nga ky dokument.

Një listë e ofruesve të mbuluar dhe të pambuluar të UMH Sparrow përditësohet çdo tremujor dhe publikohet veçmas në faqen e internetit të Sparrow. Lista mund të merret falas, në formë elektronike ose të printuar, duke vizituar faqen e internetit ose duke i telefonuar UMH Sparrow në numrin 833-227-7664.

2.0 Njoftim për mosdiskriminim

UMH Sparrow dhe të gjitha filialet e saj ofrojnë kujdes shëndetësor cilësor për të gjithë personat. UMH Sparrow nuk do të diskriminojë në bazë të racës, përkatësisë etnike, ngjyrës, origjinës kombëtare, shtetësisë, gjinisë, fesë, moshës, aftësive të kufizuara, bindjeve politike, identitetit gjinor, orientimit seksual, statusit të veteranit ose atij ushtarak, statusit martesor ose atij familjar dhe burimit të pagesës për shërbimet ose në ndonjë bazë tjetër që ndalohet nga legjislacioni federal, shtetëror ose vendor. Vendimet lidhur me pranimin dhe trajtimin bazohen vetëm në nevojat mjekësore të pacientit dhe në kapacitetin dhe aftësitë e institucionit për të ofruar kujdesin mjekësor dhe trajtimin e kërkuar. Qendrat e miratuara nga Korpusi i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (National Health Service Corps, NHSC) nuk do të diskriminojnë në ofrimin e shërbimeve për një individ (dhe nuk do ta bazojnë kualifikimin për në program) në aftësinë e një personi për të paguar, pavarësisht nëse pagesa për ato shërbime do të bëhej përmes Medicare, Medicaid ose CHIP.

3.0 Përkufizime:

AGB (Amounts Generally Billed) -Shumat e Faturuara Përgjithësisht për kujdesin urgjent ose të nevojshëm mjekësor për individët që kanë sigurim që e mbulon një kujdes të tillë.

Përmasa e familjes - një grup prej dy ose më shumë personash (njëri prej të cilëve është i zoti i shtëpisë) të lidhur nga lindja, martesë ose birësi dhe që banojnë së bashku; të gjithë këta persona (përfshirë anëtarët e nënfamiljes që kanë lidhje gjaku) konsiderohen si anëtarë të një familjeje. Anëtarët e familjes që nuk kanë lidhje gjaku mund të përfshihen për të llogaritur përmasën e familjes.

FPG (Federal Poverty Guidelines) – Udhëzimet Federale të Varfërisë, një matje e shumës minimale të të ardhurave vjetore që u nevojiten individëve dhe familjeve për nevojat bazë. Udhëzimet përdoren për të llogaritur përshtatshmërinë për Programet Federale dhe Shtetërore, si dhe për të llogaritur shumat e zbritjes së sistemit shëndetësor.

Zbritja e Ndhmës Financiare – 100% zbritje në tarifat e aplikueshme administruar përmes Programit të Ndhmës Financiare të UMH Sparrow (Sparrow Financial Assistance Program, SFAP).

Vështirësi Financiare – Vështirësi financiare që mund të pengojnë një pacient të paguajë tarifat e tij të kujdesit shëndetësor, përfshirë bashkëpagesat, zbritjet dhe bashkësigurimin.

Rezultati i Rikuperimit të Kujdesit Shëndetësor-Një rezultat i rikuperimit të kujdesit shëndetësor është një model vlerësimi i krijuar nga një shitës palë e tretë për të parashikuar aftësinë paguese të një individi për faturat mjekësore. Ky vlerësim i supozuar ndihmon në kualifikimin e pacientit pa qenë nevoja për paraqitje të dokumentacionit të të ardhurave.

Të ardhurat- Pagat, mëditjet, sigurimet shoqërore, pagesat për aftësitë e kufizuara, pagesat për veteranët, kompensimi i punonjësve, komisionet, tarifat, bakshishi dhe përfshin forma të tjera të të ardhurave si pensioni, përfitimet e daljes në pension, interesat, dividendët, fitimet nga vetëpunësimi dhe të ardhurat nga qiraja.

Asetet likuide – Asete që mund të konvertohen lehtësisht në para në një kohë të shkurtër: p.sh. aksionet, obligacionet, certifikatat e depozitave, paratë, etj.

Të nevojshme nga ana mjekësore-Shërbime të nevojshme mjekësore janë ato të urdhëruara nga një mjek ose ofrues i kujdesit të avancuar (Asistent i mjekut ose infermier/-e praktikant/-e) për të trajtuar gjendje shëndetësore ose për të ofruar kujdes shëndetësor parandalues të zakonshëm. Procedurat kozmetike, procedurat eksperimentale dhe shërbime të tjera të pambuluara përgjithësisht nga sigurimet janë të përjashtuara. Çdo pyetje lidhur me Nevojat Mjekësore do të shqyrtohet nga Drejtori i Mjekësisë së Sparrow.

Përmbledhje në gjuhë të thjeshtë- Një përmbledhje e Politikës së Ndhmës Financiare e cila është e lehtë për t'u kuptuar dhe shpërndarë në momentin e pranimit, daljes nga spitali, me deklaratat për faturimin dhe e shfaqur publikisht.

Qendrat Shëndetësore Rurale të Përcaktuara NHSC – Një qendër UMH Sparrow e cila është përcaktuar si Shëndet Rural prej Korpusit të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (National Health Services Corp, NHSC).

Shkalla e Tarifës Rrëshqitëse (Zbritje për të Pasiguarët) – Zbritje që zbatohet kur një pacient është i pasiguar (vetëpagesë).

UMH Sparrow – Përveç kur përcaktohet ndryshe, termi UMH Sparrow do të përfshijë të gjitha vendndodhjet e UMH Sparrow dhe të gjithë ofruesit e punësuar prej këtyre subjekteve.

Programi i Ndhmës Financiare të UMH Sparrow (Sparrow Financial Assistance Program, SFAP) – Emri i programit të ndihmës financiare të UMH Sparrow. Programi çliron pacientët që kualifikohen nga përgjegjësia e tyre financiare për shërbimet e nevojshme nga ana mjekësore të kryera nga ofruesit e UMH Sparrow në ambientet e UMH Sparrow. SFAP është një program i kujdesit bamirës.

I pasiguar/ I nënsiguar – Të përkufizuar si ata që nuk kanë mbulim të sigurimeve shëndetësore dhe/ose ata me mbulim të sigurimeve shëndetësore, por me përfitime që nuk mbulojnë shërbimet që ofrohen.

4.0 Standardet e Politikës

A. Pranueshmëria dhe Kualifikimet

1. Udhëzimet Federale të Nivelit të Varfërisë (Federal Poverty Level Guidelines, FPG për) për të Ardhurat Familjare - një pacient mund të kualifikohet për SFAP nëse të ardhurat familjare të pacientit nuk tejkalojnë 300% të FPG së përcaktuar për vitin aktual.

2. Kritere shtesë - Përveç FPG-së, pacienti duhet të plotësojë gjithashtu kriteret e mëposhtme për t'u miratuar prej SFAP.
 - a. Shërbimet duhet të jenë të nevojshme nga ana shëndetësore.
 - b. Aplikanti duhet të jetë banor i Miçiganit/Michigan në kohën e shërbimit.
 - c. Aplikanti duhet të ketë aplikuar dhe të jetë refuzuar ose nga Medicaid ose nga një plan sigurimi në Këmbimin e Sigurimit Shëndetësor/Health Insurance Exchange ose të jetë konsideruar i papranueshëm për këto programe prej Këshilltarit Financiar të UMH Sparrow.
 - d. Asetet likuide të aplikantit nuk duhet të tejkalojnë \$10.000 me përjashtimin e mëposhtëm: Pacienti mund të ketë deri në \$100.000 në një llogari pensioni, I.R.A., T.S.A ose 401K.
 - e. Kualifikimet për SFAP nuk kualifikojnë automatikisht një pacient financiarisht për trajtime që janë afatgjatë ose me kosto të lartë, për shembull, transplante, terapi qelizore ose ilaçe me kosto të lartë. Situata financiare e pacientit është vetëm një nga kriteret e ndryshme kur shqyrtohen këto trajtime.
 - f. Rrethana të urgjencës – aftësia e pacientit për të paguar duhet të vlerësohet para se të ofrohet shërbimi kurdo që të jetë e mundur, përveçse në rrethana urgjente. Rrethanat e urgjencës ndodhin kur UMH Sparrow ofron trajtim mjekësor urgjent sipas Ligjit për Trajtimin Mjekësor Urgjent dhe Para Lindjes së Fëmijës (Emergency Medical Treatment and Active Labor Act, EMTALA). UMH Sparrow ofron kujdes për gjendjet mjekësore urgjente (brenda kuptimit të EMTALA) pa diskriminim ndaj individëve, pavarësisht kualifikimit sipas kësaj Politike.
 - g. Pacienti që do të kualifikohej për Medicaid ose sigurim tjetër – Pacientët që do të kualifikoheshin financiarisht për Medicaid ose sigurime të tjera mund të kualifikohen për zbritje në ndihmë financiare lidhur me shërbimet e nevojshme nga ana mjekësore të pambuluara, bashkëpagesat, detyrimet e zbritshme dhe bashkësigurimin bazuar në udhëzimet për të ardhurat dhe kritere të tjera në numrat 1 dhe 2.
 - h. Pacientët që nuk do të kualifikoheshin për Medicaid – Pacientët që plotësojnë kriteret e ndihmës financiare të UMH Sparrow, por të cilët nuk kualifikohen financiarisht për Medicaid mund të kualifikohen për zbritjen në ndihmë financiar lidhur me përfitimet e mohuara për kushtin paraekzistues ose përfitimet e ezauruara. Aplikanti duhet të ketë ezauruar të gjitha burimet e tjera financiare dhe të dëshmojë vështirësi financiare.
 - i. COBRA – Pacientët që kualifikohen për COBRA, por kanë refuzuar mbulimin, sepse kostoja është më e madhe se 25% e të ardhurave të tyre mujore neto mund të kualifikohen për një zbritje në ndihmë financiare.
 - j. Vlerësimi i bamirësisë së prezumuar – Pacientët mund të kualifikohen për ndihmë financiare përmes një vlerësimi prezumes bamirësie kur dokumentacioni për të përcaktuar FPG nuk është lehtësisht i disponueshëm nga pacienti.
 - k. Përjashtime – Rastet shtesë mund të autorizohen për zbritje të ndihmës financiare në bazë përjashtimore. Çdo përjashtim nga dispozitat e renditura më sipër kërkon miratimin e Bordit të përjashtimit të përpunimit të zbritjes së ciklit të të ardhurave/ Revenue Cycle Discount Processing Exception Board (Bordi i Përjashtimit).

B. Kushtet dhe Mbulimi

1. Kualifikimi është i vlefshëm për dymbëdhjetë (12) muaj nga data e miratimit.
2. Kualifikimi përfshin balancat retroaktive pavarësisht moshës së llogarisë.
3. Kualifikimi do të përfundojë dymbëdhjetë (12) muaj nga data e miratimit.
4. Aplikantët duhet të riaplikojnë për SFAP çdo dymbëdhjetë (12) muaj.
5. Nëse një aplikant kualifikohet për sigurime të tjera si Medicare ose një plan të Tregut të kujdesit të përballueshëm shëndetësor/ Affordable Care Act Marketplace, por ka humbur periudhën e regjistrimit të hapur për atë plan, SFAP mund të miratohet deri në periudhën e ardhshme të regjistrimit të hapur.
6. Ndhima financiare SFAP përfshin të gjitha shërbimet mjekësore të nevojshme të ofruara prej ofruesve të punësuar prej UMH Sparrow në ambientet e UMH Sparrow.
7. Pacientët që kualifikohen për SFAP mund të mos tarifohen më shumë se Shumat përgjithësisht të faturuara (ABG) për shërbimet e urgjencës ose shërbime të tjera të nevojshme nga ana mjekësore. UMH Sparrow përdor metodën e "look-back" (metoda e rikthimit pas) për të përcaktuar Shumat përgjithësisht të faturuara (Amounts Generally Billed, AGB), siç kërkohej nga ligji federal. Ju lutemi, mbani mend se sapo të konsiderohen të kualifikuar për SFAP, pacientët nuk do të faturohen për kujdes mjekësor të nevojshëm, duke qenë se të gjitha këto tarifa janë fshirë për shkak të zbritjes 100%.
8. SFAP nuk përfshin shërbime që nuk konsiderohen të nevojshme nga ana mjekësore prej ofruesit(-ve) trajtues të pacientit nga UMH Sparrow.
9. SFAP nuk shtrihet te shërbimet e paofruara nga UMH Sparrow.
10. SFAP ka një detyrim ligjor dhe kontraktor të mbledhë bashkëpagesat, bashkësigurimin e lejuar dhe shumat e zbritshme. Megjithatë, një pacient mund të përfitojë ndihmë financiare për balancat e mbetura pas sigurimit nëse mund të provohet vështirësia financiare. UMH Sparrow do të përcaktojë

vështirësinë financiare në përputhje me ligjet e shtetit dhe ato federale, përfshirë agjencitë rregullatore që veprojnë në emër të tyre. Balancat e mbetura për pacientët që janë përcaktuar se kanë një vështirësi financiare do të fshihen.

11. Gjatë periudhës së pranueshmërisë për SFAP, nëse një pacient bëhet i përshtatshëm për Medicaid ose sigurim tjetër dhe/ose nëse ndodh një ndryshim në statusin financiar të pacientit, pacienti duhet të informojë ekipin e SFAP. Këto ndryshime mund të ndikojnë në kualifikimin e pacientit për zbritje të ndihmës financiare.

C. Aplikim për ndihmë financiare

1. Pacienti mund të aplikojë për zbritje SFAP duke:
 - a. Plotësuar aplikimin e gjendur në faqen e internetit të UMH Sparrow:
www.uofmhealthsparrow.org
 - b. Kontaktuar një Këshilltar financiar të UMH Sparrow duke telefonuar në numrin 517 364 6060.
 - c. Kontaktuar Shërbimin e faturimit për Klientët e UMH Sparrow duke telefonuar në numrin 517 364 7999
 - d. Marrë një kopje të aplikimit në letër, e cila është e disponueshme në çdo institucion ose zyrë të UMH Sparrow.
2. Kriteret e dokumentacionit për aplikimin SFAP përfshijnë:
 - a. Deklarata Federale për Tatimin mbi të Ardhurat për vitin më të fundit fiskal (Formulari 1040)
 - b. Deklarata më e fundit e Pagës dhe tatimeve (W-2) dhe/ose të Ardhurat e ndryshme (Formulari 1099)
 - c. Kopja e fundit e fletëpagesës me fitimet e përditësuara për çdo anëtar të familjes
 - d. Prova për të ardhura të tjera; shembuj, kompensimi i papunësisë, të ardhurat për shkak të aftësisë së kufizuar, të ardhurat nga qiraja, pensionet, rentat, pagesat e interesit
 - e. Kopje e shkresës për përfitimet nga sigurimet shoqërore për vitin aktual
 - f. Vërtetim aktual bankar i llogarive rrjedhëse/kursimi
 - g. Dokumentacioni për rezidencën në Miçigan/ Michigan
 - h. Vërtetime IRA/401K
 - i. Përgjigje prej Medicaid, Healthy Michigan ose Marketplace
 - j. Për pacientët dhe familjet me zero (0) të ardhura, një Deklaratë e mbështetjes për nevojat bazë për të gjithë pjesëtarët e familjes
 - k. Dokumentacioni për çdo aset/burim tjetër likuid

D. Administrimi i zbritjes së ndihmës financiare

1. UMH Sparrow nuk do të ndërmarrë veprime të jashtëzakonshme të arkëtimit kundër një individi para se të bëjë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse individi është i kualifikuar për ndihmë sipas kësaj politike. Cikli i të ardhurave ka një politikë të faturimit dhe arkëtimit që përshkruan veprimet që mund të marrë UMH Sparrow në rast mospagese, përfshirë veprimet për arkëtim. Këto politika janë të disponueshme pranë departamentit të Ciklit të të ardhurave (Revenue Cycle) të UMH Sparrow ose përmes informacionit të mëposhtëm të kontaktit.
2. Procedurat e detajuara për të menaxhuar këtë politikë mirëmbahen prej Ciklit të të ardhurave (Revenue Cycle) të UMH Sparrow.
3. Administrimi i korrigjimit të ndihmës financiare do të zbatojë procedurat me shkrim. Korrigjimi i ndihmës financiare nuk mund të fillohet ose miratohet prej një punëmarrësi kur ekziston një konflikt interesi me atë person, qoftë mik ose i afërm.
4. Një Përmbledhje në gjuhë të thjeshtë (Plain Language Summary) e programit SFAP është e disponueshme në Shtojcën D.

E. Publikimi i politikës së ndihmës financiare

1. Spitaleve u kërkohet të publikojnë gjerësisht politikën e ndihmës së tyre financiare në komunitetet që i shërbejnë. UMH Sparrow angazhohet të veprojë në përputhje me këtë kërkesë duke:
 - a. Përfshirë dispozitat kyçe të SFAP në faqen e jashtme të internetit të UMH Sparrow
 - b. Bërë të disponueshme materialet e printuara përmes ambienteve të kujdesit ndaj pacientëve të UMH Sparrow
 - c. Përfshirë informacionin për SFAP në deklaratat e pacientëve
 - d. Përfshirë informacion sesi të aplikohet për ndihmë financiare ose të aksesohet SFAP në deklaratat e pacientëve.

F. Informacioni i kontaktit

1. Këshillimi Financiar në numrin 517 364 6060 ose pa pagesë në numrin 833-227-7664
2. Shërbimi ndaj klientit në numrin 517 364 7999
3. Faqe ueb uofmsparrow.org/financial assistance
4. Një kopje e shtypur në letër e politikës së Ndhmës financiare, aplikimit për ndihmë dhe si të llogaritet AGB mund të merret duke kontaktuar zyrën e Këshillimit financiar duke përdorur informacionin e kontaktit të përmendur më sipër. Gjithashtu, aplikacioni dhe dokumentet SFAP mund të printohen në faqen ueb të UMH Sparrow.

5.0 Historia e përditësimit:

Data	Përditësimi #	Ndryshime	Seksioni i referuar
01/01/16		Politika e re	
2017		Përditësimi i tabelës FPL	
2018		Përditësimi i tabelës FPL	
2019		Përditësimi i tabelës FPL	
2020 10/2/2021		Përditësimi i tabelës FPL Përditësimi i tabelës FPL	
9/2022		Përditësimi i përkufizimit të familjes Shtoni tabelën FPL në vend të lidhjes. Shtesa e Medicaid ESO Shtoni kontaktin e informacionit të Këshillimit financiar në udhëzime. Shtoni numrin e telefonit të Këshillimit financiar. Shtoni të nevojshmen nga ana mjekësore të qëllimi	
11/10/2022 (10 nëntor 2022)		Përditësoni politikën për të përmbushur qëllimin e kërkesave të NHSC	
02/15/2023 (15 shkurt 2023)		Përditësimi i tabelës FPL	Seksioni 5.2 i Tabelës FPL
11/07/2023 (7 nëntor 2023)		Përditësimi i Vendndodhjeve të shëndetit rural	SHTOJCA D
02/01/2024 (1 shkurt 2024)		Përditësimi i tabelës FPL	Seksioni 5.2 i Tabelës FPL
01/01/2025 (1 janar 2025)		Ndani SFAP dhe Shëndeti rural SFAP Përditësoni zonën e Shërbimit Sparrow në banor të Miçiganit/ Michigan. Hiqni SFAP të shkallëzuar 50%. Shtoni 100% deri në 300% FPG. Shtoni asete likuide \$ 10.000.	
02/01/2025 (1 shkurt 2025)		2025 Përditësimi i tabelës FPL	Shtojca B
10/01/2025 (1 tetor 2025)		Përditësimi i ofruesve të mbuluar dhe të pambuluar	1.0 Deklarata e Politikës, qëllimi dhe fushëveprimi 2.0 Shtojca D, përmbledhje në gjuhë të thjeshtë 4.0 B 11 është hequr

Shtojca A:
Zbritjet dhe shkalla e tarifës rrëshqitëse e UMH Sparrow

Lloji i zbritjes	Kriteret e kualifikimit	Metoda e aplikimit	Shuma e zbritjes
<u>I/e pasiguar</u> Kujdesi falas	E ardhura e familjes <= 100% e <u>FPG</u>	<u>Aplikimi për ndihmë financiare</u> i Sparrow	100%
<u>I/e pasiguar</u> Kujdesi falas	E ardhura e familjes <= 200% e <u>FPG</u>	Aplikimi për ndihmë financiare i Sparrow	100%
<u>I/e pasiguar</u> (Vetë-pagesë) Zbritja e tarifës rrëshqitëse	Pacient i pasiguar	Asnjë	<u>AGB</u> (Shtojca C)
Zbritja e kujdesit të pasiguar dhe të siguar të bamirësisë	Të ardhura familjare deri në 300% të <u>FPG</u>	<u>Aplikimi për ndihmë financiare</u> i Sparrow, Vlerësimi i rikuperimit të kujdesit shëndetësor nuk do të përdoret	<=300% FPG = 100% zbritje.
Zbritja e Anëtarit të Planit Shëndetësor Ingham	Anëtar aktiv në IHP	Asnjë	100%
Zbritje e Anëtarit ESO të Medicaid	Anëtar aktiv në Medicaid ESO për CHAMPS	Asnjë	100%
I/e vdekur	Dëshmi e certifikatës së vdekjes	Asnjë	100%
Zbritje e <u>Vlerësimit të Rikuperimit të Kujdesit Shëndetësor</u>	Vlerësimi < 650 vetëm për pacientët e pasiguar. Bashkëpagesat, zbritjet dhe bashkësigurimi nuk janë të kualifikuara për këtë metodologji	Asnjë- E kontrolluar automatikisht para veprimit të arkëtimit nga palët e treta.	100%

Shtojca B
Tabela aktuale FPG

Shumat FPG përditësohen në shkurt të çdo viti, prej Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore (Department of Health and Human Services, DHHS) dhe kriteret FPG të politikës së Ndihmës financiare Sparrow të Universitetit të Miçiganit (University of Michigan) rregullohen për të reflektuar përditësimet vjetore.

2/1/2025 Shuma e zbritjes SFAP

Masa (madhësia) e familjes	FPG <100%		FPG 300%
1	\$ 15,650		\$ 46,950
2	\$ 21,150		\$ 63,450
3	\$ 26,650		\$ 79,950
4	\$ 32,150		\$ 96,450
5	\$ 37,650		\$ 112,950
6	\$ 43,150		\$ 129,450
7	\$ 48,650		\$ 145,950
8	\$ 54,150		\$ 162,450
Për çdo anëtar familjar shtesë, shtoni sa më poshtë:			
	\$ 5,500		\$ 16,500

Shtojca C
Aplikimi për ndihmë financiare

Data e aplikimit: _____

Numri i telefonit të aplikantit: _____

Informacioni për pacientin		
Emri (-at)	Mbiemri (-at)	Data (-at) e lindjes

Faleminderit për interesin tuaj në programin e ndihmës financiare UMH-Sparrow (Sparrow Financial assistance program, SFAP). Bashkëngjitur gjeni aplikimin dhe formularin për kufizimin e përgjegjësisë. Informacioni i mëposhtëm është një listë kontrolli e dokumenteve që kërkohen prej jush. Nëse jeni i/e martuar, sigurohuni të përfshini dokumentet prej bashkëshortit/-es tuaj/suaj. Mund t'ju kërkohet gjithashtu të përfshini dokumente nga anëtarë të tjerë të familjes.

	Dokumentet e kërkuar
	Vetëm faqet 1 dhe 2 të Formularit 1040 të Deklaratës federale për tatimin mbi të ardhurat për vitin më të fundit (përfshini W2s ose 1099s) Nëse kërkohet në taksat e një personi tjetër, dërgoni informacionin tatimor të atij personi
	Kopje e fundit e fletëpagesës (-ave) me fitimet vjetore deri më sot
	Dokumente të tjera të të ardhurave si, por pa u kufizuar në: - Të ardhurat nga sigurimet shoqërore - Detyrimi ushqimor për fëmijë - Detyrimi ushqimor për ish-gruan
	Vërtetim (-et) aktual/e bankar/e për llogaritë rrjedhëse dhe të kursimit (nëse jeni i/e martuar, llogaritë e përbashkëta dhe të ndara)
	Kopje e kartës suaj të identitetit (leje drejtimi automjeti, kartë identiteti shtetërore ose ushtarake)
	Deklaratat e pensionit (IRA/401K/Pension)
	Verifikimi i nevojave bazë, nëse nuk keni të ardhura

Për të kthyer aplikimin dhe dokumentet tuaja:

- Dërgoni informacionin me postë në:
 - UMH-Sparrow, Këshillimi Financiar, 1215 E. Michigan Ave, Lansing, MI 48906
- Faksoni informacionin në numrin 517 364 2186

Për pyetje, mund t'i drejtoheni Këshilltarit tuaj financiar SFAP në numrin 517.364.6060.

Informacion financiar. "Duhet të sjellë vërtetim"				
Të ardhurat mujore	Aplikanti	Bashkëshorti/-ja (tjetër)	Aplikanti	Bashkëshorti/-ja (tjetër)
*Punësimi	\$	\$	*Llogaria rrjedhëse ☐ Nëse nuk ka asnjë, shënojeni këtu	*Llogaria rrjedhëse ☐ Nëse nuk ka asnjë, shënojeni këtu
			☐ Nëse nuk ka asnjë, shënojeni këtu	
*Sigurimet shoqërore	\$	\$	*Balanca \$	*Balanca \$
*Pensioni/rentat	\$	\$		
*Të ardhura të tjera	\$	\$	*Llogaria e kursimit ☐ Nëse nuk ka asnjë, shënojeni këtu	*Llogaria e kursimit ☐ Nëse nuk ka asnjë, shënojeni këtu
			☐ Nëse nuk ka asnjë, shënojeni këtu	
			*Balanca \$	*Balanca \$
*IRA / 401K	\$	\$		

Informacioni familjar		
Informacioni familjar përkufizohet nga personat që përfshihen në një deklaratë të vetme tatimore		
Emri:	Marrëdhënia:	Mosha:

Kufizimi i përgjegjësisë

Mund të marrim një raport kredie për të verifikuar informacionin e mësipërm dhe sipas ligjeve të privatësisë, nuk do të ndajmë këtë informacion me palë të jashtme. Nënshkrimi juaj në këtë aplikim tregon se jeni në dijeni dhe jepni miratimin tuaj për përdorimin e këtij raporti, si dhe konfirmon se keni dhënë informacion të saktë për fitimet, financat, të ardhurat, pronësinë dhe mbulimin tuaj të sigurimeve. Nëse ndonjë informacion në aplikimin tuaj ndryshon, jeni përgjegjës për përditësimin e menjëhershëm të informacionit tuaj pranë UMH-Sparrow. Nëse nuk raportoni ndryshimet ose nëse ka mashtrim apo abuzim, mund të sjellë përjashtimin tuaj nga programi SFAP dhe UMH-Sparrow mund t'ju konsiderojë përgjegjës për kostot mjekësore që ishin mbuluar sipas SFAP.

Mund të vendosim një barrë siguroese mbi çdo padi të ardhshme, padi pezull ose politika rimbursimi (p.sh. AFLAC) për shërbimet lidhur me rimbursimin që ju merrni ndërsa jeni të mbuluar prej SFAP.

*Ju lutemi, vendosni inicialet këtu për të treguar që keni lexuar dhe kuptuar këtë kufizim përgjegjësie: _____

Nënshkrimi i Aplikantit ose Kujdestarit Ligjor: _____

Data: _____

** Për të shqyrtuar aplikimin tuaj në kohë, ju lutemi, kthejeni atë sa më shpejt që të jetë e mundur.**

Ky aplikim duhet të përdoret prej UMH-Sparrow për t'ju asistuar me zgjidhjen e detyrimit tuaj financiar. I gjithë informacioni në aplikim do të mbahet konfidencial.

Dokumentacioni i Nevojave Bazë
Ju lutemi, plotësojeni nëse raportoni zero të ardhura.

Data: _____

Emri i pacientit: _____ Data e lindjes: _____

Vendosni inicialet në çdo seksion dhe nënshkruani aty ku duhet:

_____ Aktualisht, nuk marr asnjë të ardhur
E ardhura përfshin, por nuk kufizohet te – pagat e punësimit, pagesat e aftësisë së kufizuar,
kompensimi për papunësinë, pensioni, rentat, të ardhurat nga qiraja ose sigurimet shoqërore.

_____ Nevojat e mia bazë (ushqimi, veshjet dhe strehimi) plotësohen nga:

(Plotësoni emrin e individit ose agjencisë që furnizon nevoja bazë).

_____ I jap autorizimin UMH-Sparrow për të verifikuar se nevojat e mia bazë plotësohen prej individit ose agjencisë së lartpërmendur.

Nënshkrimi i Pacientit ose i Përfaqësuesit

Data

SHTOJCA D PËRMBLEDHJE NË GJUHË TË THJESHTË E FAP

PËRMBLEDHJE NË GJUHË TË THJESHTË E POLITIKËS SË NDIHMËS FINANCIARE

UMH Sparrow është i përkushtuar t'u shërbejë banorëve të Shtetit të Miçiganit/ Michigan që nuk mund të marrin kujdesin mjekësor të nevojshëm për shkak të pamundësisë për të paguar.

Pranueshmëria

Programi ynë i ndihmës financiare quhet Programi i Ndihmës Financiare Sparrow (Sparrow Financial Assistance Program, SFAP). Ja si përcaktojmë kush përfiton nga SFAP:

- Të ardhurat e familjes nuk duhet të tejkalojnë 300% e Nivelit federal të varfërisë.
 - Informacioni rreth Nivelit federal të varfërisë mund të gjendet këtu:
<https://www.healthcare.gov/glossary/federal-poverty-level-fpl/>
- Pacienti është banor i shtetit të Miçiganit/ Michigan.
- Shërbimet konsiderohen të nevojshme nga ana mjekësore – kjo përcaktohet nga ofruesi i UMH Sparrow që kryen shërbimet.
- Nëse nuk përmbushni të gjitha kërkesat, mund të konsideroheni në bazë përjashtimi rast pas rasti. Kontaktoni një Këshilltar Financiar në numrin 517-364-6060 ose 833-227-7664 për më shumë informacion.

Çfarë mbulohet nga SFAP

- 100% e kujdesit të pacientit në UMH Sparrow kur pacienti nuk ka sigurim
- Shërbimet që nuk mbulohen për pacientët e UMH Sparrow që kanë sigurim.

Si të aplikoni për SFAP

- Kontaktoni këshilltarët tanë financiarë në numrin 517-364-6060 ose 833-227-7664, nga e hëna në të premte, ora 8:00 – 16:00
- Plotësoni një aplikim SFAP online:
<https://www.uofmhealthsparrow.org/patient-resources/financial-resources/financial-assistance>
- Kontaktoni Shërbimin ndaj klientit në numrin 517 364 7999

Pacientët që përfitojnë nga SFAP nuk mund të tarifohen më shumë se Shumat përgjithësisht të faturuara (Amounts Generally Billed, AGB) për kujdesin mjekësor të nevojshëm. Ju lutemi vini re se, sapo të konsideroheni të pranueshëm për ndihmën financiare të SFAP, pacientët nuk do të faturohen për kujdesin mjekësor të nevojshëm, pasi të gjitha këto shpenzime fshihen për shkak të zbritjes 100%.

Kopje në letër të dokumenteve dhe aplikacioneve SFAP në gjuhë të ndryshme

Nëse dëshironi kopje në letër të kësaj përmbledhjeje, politikës së plotë të ndihmës financiare ose një aplikimi në një gjuhë tjetër, ju lutemi, na njoftoni duke na kontaktuar në numrat e telefonit ose faqen e internetit të përmendur më lart. Aplikacionet janë në dispozicion në gjuhët shqip, arabisht, bengalisht, kinezçe, anglisht dhe spanjisht.

Lista e ofruesve: Një listë e ofruesve që ofrojnë kujdes urgjent dhe mjekësor të nevojshëm në UMH Sparrow dhe që mbulohen nga Politika e Ndihmës Financiare është në dispozicion në [faqen e internetit](#) ose duke telefonuar UMH Sparrow në numrin 517-364-6060 ose 833-227-7664.

SHTOJCA E
Shumat përgjithësisht të faturuara (Amounts Generally Billed, AGB)

Shumat përgjithësisht të faturuara UMH Sparrow llogarisin përqindjen e shumave përgjithësisht të faturuara (AGB) duke përdorur metodën “lookback” (shikim mbrapa). AGB përlllogaritet duke pjesëtuar shumën e të gjithë tarifave për shërbimin e Medicare dhe siguruesve shëndetësore privatë që kanë paguar pretendime në Institucionin HFHS gjatë një periudhe 12 mujore, me shumën e tarifave bruto shoqëruese për ato pretendime, të gjitha në përputhje me IRS Reg. Sec. 1.501(r)-5(b)(3). Përqindjet e AGB përditësohen çdo vit. Një AGB e konsoliduar më e ulët se disa prej kredive të llogaritura do të përdoret për thjeshtësi. Për UMH Sparrow, do të përdorim AGB të përmendur më poshtë prej 25%. Të dhënat nga Janar 2020 deri në Dhjetor 2020 janë përdorur për të llogaritur AGB për vitin financiar 2021. SHUMAT PËRGJITHËSISHT TË FATURUARA (AGB).

Të dhënat nga Janar 2020 deri në Dhjetor 2020 janë përdorur për të llogaritur AGB për vitin financiar 2021.

Vendndodhja	AGB
Lansing	29%
Clinton	43%
Ionia	44%
Carson City	41%
Eaton	51%
SISTEMI SHËNDETËSOR UMH SPARROW	25%

SHTOJCA F
Vendndodhje të miratuara nga NHSC

Për Vendndodhjet e miratuara nga NHSC, miratimi ose refuzimi i SFAP bazohet vetëm në të ardhura dhe madhësinë e familjes dhe rregullohet prej një programi dhe aplikimi të veçantë të Ndhmës financiare.

University of Michigan Health – Sparrow Carson Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Ithaca Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Greenville Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Stanton Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Carson OBGYN (Gjinekologji dhe Obstetrikë)
University of Michigan Health – Sparrow Ionia Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Portland Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Saranac Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Charlotte 111 Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow 123 Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Eaton Rapids Kujdesi Parësor
University of Michigan Health – Sparrow Charlotte IM/Peds Kujdesi Parësor